

RAPORTI “PEER REVIEW”

MBI PËRPUTHSHMËRINË E SISTEMIT STATISTIKOR TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS ME KODIN E PRAKTIKËS SË STATISTIKAVE EVROPIANE DHE
ROLI KOORDINUES I AGJENCISË SË STATISTIKAVE

KOSOVË

JEAN-MICHEL DURR

PETER HACKL

MARIUS ANDERSEN

GUSHT 2017

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3
LISTA E SHKURTESAVE	6
1. HYRJE	7
2. PËRSHKRIM I SHKURTËR I SISTEMIT KOMBËTAR STATISTIKOR	8
3. PËRPUTHSHMËRIA ME KODIN E PRAKTIKËS DHE ROLI I BASHKËRENDIMIT BREnda SISTEMIT KOMBËTAR TË STATISTIKAVE	11
3.1 Fuqitë e insitutit kombëtar të statistikave në lidhje me përputhjen e saj me kodin e praktikës dhe me rolin bashkërendues	11
3.2 Cështjet dhe rekomandimet	12
3.2.1 Konsolidimi i kuadrit insitucional	12
3.2.2 Rritja e burimeve dhe përmirësimi i efektivitetit të kostos	15
3.2.3 Zhvillimi i menaxhimit të cilësisë dhe metodologjisë	17
3.2.4 Forcimi i marrëdhënieve me përdoruesit	21
3.3 Pikëpamjet e institutit kombëtar të statistikave që dallojnë nga vlerësimi i Ekipit të “Peer Review”	22
SHTOJCA A: PROGRAMI I VIZITËS	24
SHTOJCA B: LISTA E PJESËMARRËSVE	26

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Kosovë, sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare¹. Kuadri ligjor i Sistemit Kombëtar Statistikor të Kosovës është gjithëpërfshirës dhe mbulon fushat kryesore të cilat rregullojnë statistikave zyrtare në BE. Pavarësisht se është institucion i ri, ASK-ja gëzon nivel të lartë të besimit dhe pavarësia e saj njihet gjerësisht.

Duke përdorur dispozitat e Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja ka zhvilluar përdorimin e gjerë të dhënave administrative dhe ka krijuar bashkëpunim të ngushtë me ofruesit e të dhënave administrative përmes grupeve punuese ku diskutohen karakteristikat teknike të këtyre burimeve.

Faqja e re e internetit e ASK-së është moderne dhe atraktive dhe unanimsisht vlerësohet nga përdoruesit. Të gjitha publikimet dhe njoftimet për shtyp publikohen në mënyrë sistematike në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, duke mundësuar shikueshmëri të madhe ndërkombëtare.

Ekipi i “Peer Review” identifikoi katër çështje të gjera ku mund të përmirësohet përputhshmëria me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane. Këto çështje lidhen me konsolidimin e kuadrit institucional, me rritjen e burimeve dhe me përmirësimin e efektivitetit të kostos, me zhvillimin e menaxhimit të cilësisë dhe metodologjisë, si dhe me forcimin e marrëdhënieve me përdoruesit.

Përderisa Ligji për Statistikat Zyrtare është gjithëpërfshirës, rishikimi i saj i planifikuar duhet të ofrojë mundësinë për zgjatjen e mandatit të Shefit të ASK-së dhe përforcimin e përgjegjësisë së tij/saj në lidhje me metodologjinë statistikore, si dhe përfshirjen e dispozitave për zbatimin e përfshirjes së ASK-së në dizajnimin dhe modifikimet e të dhënave administrative. Roli bashkërendues i ASK-së, ende po zhvillohet në kontekst të institucioneve të reja statistikore². Prandaj, ASK-ja duhet të përfitojë nga situata në mënyrë që të vendosë autoritetin e saj si koordinator i sistemit statistikor, dhe, për shembull, të krijojë kritere për statistikave zyrtare.

Derisa burimet financiare të ASK-së janë rritur vazhdimisht gjatë viteve të fundit, ato ende janë të pamjaftueshme që t'i mundësojnë ASK-së të përmbush mandatin kombëtar dhe ndërkombëtar. ASK-ja ka identifikuar nevojën për 48 pozita të reja, përveç 149 të lejuara deri më tani. Prandaj, është me rëndësi të madhe që të sigurohen burime të qëndrueshme për ASK-në, për të përmbushur detyrimet e saj aktuale dhe të ardhshme statistikore. ASK-ja inkurajohet të vazhdojë me rialokimin e burimeve nga shtatë zyrat rajonale, duke përfutur nga përdorimi i teknologjive të reja në mënyrë që të rrisë produktivitetin.

Duke pasur parasysh mungesën e burimeve të saj, ASK-ja duhet të zhvillojë më tej menaxhimin e cilësisë për të rritur efektivitetin e vet në kosto, duke ndjekur parimin e përmirësimit të vazhdueshëm në identifikimin e dobësive dhe kërkimit të proceseve, rezultateve dhe shërbimeve që çojnë në përmirësim. Modeli i prodhimit të statistikave të ASK-së është ende kryesisht i “tipit të furrës”. Më shumë efikasitet mund të fitohet duke kaluar në një model të integruar të prodhimit statistikor, një lëvizje në të cilën shumë nga Institutet Kombëtare të Statistikave (IKS) brenda Bashkimit Evropian janë të angazhuar dhe po bëjnë përparim. Zhvillimet e reja në metodologji, për shembull, në mbledhjen e të dhënave, duhet të ndihmojnë ASK-në të rrisë cilësinë e rezultateve të saj.

Në fund, Ekipi i “Peer Review” inkurajon ASK-në që të forcojë marrëdhëniet e saj me përdoruesit dhe, në veçanti, me akademinë, për të marrë reagime mbi produktet e saj dhe për të nxitur bashkëpunimin, për shembull, për të zhvilluar analizimin e statistikave të saj. Në përgjithësi, Ekipi i “Peer Review” konsideron se ASK-ja është në përputhje me KoP-in (Kodin e Praktikës të Statistikave

¹ LIGJI NR. 04 / L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS. GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 26/25 NËNTOR 2011, PRISHTINË

² ASK u ri-themelua në vitin 1999 pas një ndërprerjeje prej 9 vjetësh.

Evropiane). Rekomandimet në këtë raport kanë për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të përputhshmërisë.

REKOMANDIMET

Konsolidimi i kuadrit institucional:

1. Rishikimi i ardhshëm i Ligjit të Kosovës për Statistikat Zyrtare duhet të ketë parasysh ruajtjen e pavarësisë profesionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe të deklarojë se kreu i Agjencisë është përgjegjës i vetëm për të vendosur mbi metodat, standardet dhe procedurat statistikore, duke zgjeruar mandatin e tij / saj në një periudhë më të gjatë se aktualisht. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesit 1.3 dhe 1.4.)
2. Ligji i Kosovës për Statistikat Zyrtare duhet të përmbajë dispozita specifike mbi të drejtën e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për t'u përfshirë në hartimin e regjistrave administrativë që përdoren ose mund të përdoren për qëllime statistikore, dhe të konsultohet për ndryshimet dhe shuarjen ose mbylljen e këtyre regjistrave dhe shënimeve administrative. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 2.)
3. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të forcojë kulturën e korporatës për konfidencialitetin / besueshmërinë duke bërë që stafi i saj të kuptojë dhe të angazhohet plotësisht për të zbatuar konfidencialitetin statistikor. Për më tepër, ASK-ja duhet të garantojë ofruesit kryesorë të të dhënave për zbatimin e konfidencialitetit statistikor. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 5.)
4. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të përforcojë rolin e vet bashkërendues në Sistemin Kombëtar të Statistikave duke i mundësuar Autoriteteve të tjera Kombëtare dhe Sistemit Kombëtar të Statistikave që të kenë shikueshmëri në faqen e saj të internetit dhe të shkëmbejnë standardet statistikore relevante për prodhimin e Statistikave Zyrtare, siç janë klasifikimet. (Koordinimi)
5. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të qartësojë përkufizimin e Statistikave Zyrtare duke përcaktuar një sërë kriteresh të bazuara në Kodin e Praktikës (KoP) dhe krijimin e një mekanizmi për vlerësimin sistematik të përputhshmërisë me këto kritere nga të gjitha Institutet Kombëtare të Statistikave apo AtK relevante. Një Komitet i Posaçëm Koordinues, që i bashkëngjitet Këshillit të Statistikave, mund të krijohet me mandatin për të vlerësuar përputhshmërinë me kriteret e kërkuara për t'u kualifikuar si prodhues i Statistikave Zyrtare. (Koordinimi, Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 14.)

Rritja e burimeve dhe përmirësimi i efektivitetit të kostos:

6. Autoritetet kombëtare të Kosovës duhet të sigurojnë burime adekuate për t'i mundësuar Agjencisë së Statistikave të Kosovës që të përmbushë detyrimet e saj kombëtare dhe ndërkombëtare. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 3.)
7. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të vazhdojë të monitorojë ngarkesën e punës dhe produktivitetin e zyrave të saj rajonale në mënyrë që të lirojë burimet potenciale të disponueshme për t'u rialokuar për aktivitete të tjera në selinë e saj. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 10.)
8. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të synojë rritjen e kapaciteteve të stafit të saj duke zhvilluar program trajnimi të brendshëm, duke u bazuar në trajnimin e gjerë tashtmë të ofruar nga organizatat ndërkombëtare. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesi 7.6.)

Zhvillimi i menaxhimit të cilësisë dhe metodologjisë

- 9 Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të krijojë sistem më të gjerë të menaxhimit të cilësisë. Menaxheri i Cilësisë, një ekspert i lartë përgjegjës për cilësinë, duhet të përmbushë rolin e Koordinatorit të Cilësisë dhe të raportojë direkt tek Kryeshefi Ekzekutiv. Grupi Drejtues i Cilësisë duhet të mbështesë dhe udhëzojë Menaxherin e Cilësisë si komision ndër-organizativ i cilësisë. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesi 4.)
- 10 Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të krijojë procese për të monitoruar dhe kontrolluar punën e anketuesve ose intervistuesve të cilët kryejnë punën e mbledhjes së të dhënave. Fokusi duhet të jetë në aspektet si paanshmëria, besueshmëria dhe dimensionet përkatëse të cilësisë. Rezultatet e këtij monitorimi duhet të përdoren për të përmirësuar proceset e mbledhjes së të dhënave. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesi 12.1.)
- 11 Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të rrisë përdorimin e pajisjeve elektronike për mbledhjen e të dhënave. Duhet të angazhohet në zhvillimin e sistemit elektronik për mbledhjen e të dhënave. Mbledhja e të dhënave nga Intervistimi Personal i Ndihmuar me Kompjuter (CAPI), Intervistimi me Telefon i Ndihmuar në Kompjuter (CATI) dhe pyetësorët elektronikë duhet të zhvillohen në mënyrë që të fitohet efikasitet dhe të rritet cilësia e të dhënave. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesit 9.3 dhe 10.2.)
- 12 Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të angazhohet në zhvillimin e moduleve të Modelit për Procesin Gjenerik të Statistikave të Biznesit (GPGJSB) për të rritur efektivitetin e kostos së proceseve statistikore dhe për të rritur cilësinë e produkteve statistikore. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesit 8.1-8.8.)

Forcimi i marrëdhënieve me përdoruesit

- 13 Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të forcojë marrëdhëniet me përdoruesit në bazë të grupeve punuese sipas lëndës në mënyrë që të kuptojë më mirë nevojat e përdoruesve dhe që të pranojë reagime në lidhje me përvojat e tyre me produktet statistikore. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesi 11.1.)
- 14 Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të zhvillojë marrëdhënie më të forta me akademinë duke zgjeruar shërbimin e saj për qasje në të dhëna duke përfshirë mikro-të dhëna anonime për qëllime kërkimore, duke ofruar praktika për studentët dhe duke bashkëpunuar në kryerjen e analizave të përbashkëta. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesit 7.7 dhe 15.4.)

LISTA E SHKURTESAVE

CAPI	Intervistimi Personal i Ndhimuar në Kompjuter
CATI	Intervistimi me Telefon i Ndhimuar me Kompjuter
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
KoP	Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane
ESMS	Struktura, e meta të dhënave Euro-SDMX
SES	Sistemi Evropian Statistikor
EU-SILC	Anketa e të ardhurave dhe kushteve të jetesës së Bashkimit Evropian
MPGJSB	Modeli për procesin gjenerik të statistikave të biznesit, ose GSBPM
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
LSZ	Ligji mbi Statistikat Zyrtare
MoF	Ministria e Financave
MoM	Memorandumi i Mirëkuptimit
SKS	Sistemi Kombëtar Statistikor
AtK	Autoritetet e tjera Kombëtare
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

1. HYRJJE

Ky Raport i "Peer Review" është pjesë e një sërë vlerësimesh, qëllimi i së cilës është vlerësimi i shkallës në të cilën Institutet Kombëtare të Statistikave (IKS) të vendeve të zgjerimit përputhen me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane (KoP). Kjo seri e vlerësimeve bazohet në një raund të ngjashëm të rishikimeve të ekspertëve, të kryera në Shtetet Anëtare të BE-së dhe ndjek, sa më shumë të jetë e mundur, të njëjtën metodologji, të përshtatur pak me kontekstin e vendeve të zgjerimit.

KoP, i cili përcakton kornizën e përbashkët të cilësisë për SES, u adoptua për herë të parë në vitin 2005 nga Komiteti i Programit Statistikor, dhe u përditësua në vitin 2011, nga pasardhësi i saj, Komiteti Evropian i Sistemit të Statistikave. Parimet e KoP-15 dhe treguesit përkatës të praktikës së mirë - mbulojnë mjedisin institucional, procesin e prodhimit të statistikave dhe prodhimin e statistikave evropiane. SES është e përkushtuar që plotësisht të veprojë në përputhje me KoP dhe po punon drejt zbatimit të saj të plotë. Vlerësimet periodike shqyrtojnë përparimin drejt arritjes së këtij qëllimi.

Raundi i parë i rishikimeve në Shtetet Anëtare të BE-së në vitet 2006-2008, u pasua nga një raund i rishikimeve "të lehta" dhe vlerësimeve të përshtatura globale në vendet e zgjerimit në vitet 2010-2012. Rishikimet e lehta treguan se si IKS-të po përparonin në zbatimin e pjesëve të KoP-it në lidhje me mjedisin institucional dhe shpërndarjen e statistikave (parimet 1-6 dhe 15). Kjo rezultoi në raportim për çdo rishikim të IKS-ve, të disponueshme në faqen e internetit të Eurostat³. Këto raporte gjithashtu përfshijnë një sërë veprimesh përmirësuese që mbulojnë të gjitha parimet e KoP-it; këto formuan bazën e monitorimit vjetor të zbatimit të KoP-it në vendet e zgjerimit në periudhën 2011-2015.

Në përputhje me rishikimet e bëra në Shtetet Anëtare të BE-së në periudhën 2014-2015, fushëveprimi i këtij raundi të dytë të rishikimeve është më i gjerë: rishikimi i përputhshmërisë me KoP-së mbulon të gjitha parimet; rishikimi i përputhshmërisë me KoP-in i prodhuesve të tjerë kombëtarë të statistikave zyrtare (si dhe IKS-të) në çdo vend; dhe mënyra në të cilën autoritetet statistikore bashkërendojnë prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare brenda sistemeve të tyre statistikore.

Për të fituar një pikëpamje të pavarur, janë zbatuar "rishikimet e kolegëve" të cilat janë eksternalizuar me qasjen e auditimit ku të gjitha përgjigjet në pyetësorët e vetëvlerësimit duhet të mbështeten nga dëshmitë. Çdo rishikim ose "peer review" i ndërsjelltë në vendet e zgjerimit kryhet nga tre recensues dhe ka katër faza: plotësimi i pyetësorëve të vetëvlerësimit nga vendi (shteti); vlerësimi i tyre nga Rishikuesit; vizitë nga Rishikuesit; dhe përgatitja e raporteve për rezultatet.

Ekipi i "Peer Review" në Kosovë u zhvillua nga Z. Jean-Michel Durr (kryesues), Peter Hackl dhe Z. Marius Andersen me një vizitë të vlerësimit nga ana e ekspertëve në Prishtinë më 24-28 korrik 2017. Programi i vizitës është në Shtojcën A dhe Lista e pjesëmarrësve është në Shtojcën B.

Ky raport përqendrohet në përputhshmërinë me KoP-in dhe bashkërendimin e statistikave zyrtare, brenda sistemit statistikor kombëtar. Është raport që shikon përpara dhe nuk diskuton ngjarjet në të kaluarën. Në vend të kësaj, raporti thekson disa nga pikat e forta të sistemit statistikor dhe përmban rekomandime për përmirësim. Veprimet e përmirësimit, të zhvilluara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bazë të këtij raporti, do të publikohen brenda periudhës prej katër javësh, duke filluar atëherë kur raporti përfundimtar të dërgohet në IKS.

³ <http://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/enlargement-countries/publications/reports>

2. PËRSHKRIM I SHKURTËR I SISTEMIT KOMBËTAR STATISTIKOR

Legjislacioni

Ligji mbi Statistikat Zyrtare (Nr. 04/L-036) rregullon statistikat zyrtare të Kosovës, Sistemin Kombëtar të Statistikave dhe rolin e Agjencisë Kosovare të Statistikave. Ligji për Statistikat Zyrtare u miratua në vitin 2011. Ai përshkruan rolin e ASK-së si institucion profesional i pavarur dhe bartës, shpërndarës dhe koordinator i sistemit statistikor të Kosovës. Kryeshefi ekzekutiv i ASK-së emërohet sipas legjislacionit në fuqi për emërimin e punonjësve të lartë civilë.

Misioni dhe vizioni

Vizioni i sistemit statistikor të Kosovës është njohja si një ofrues i besueshëm dhe i paanshëm i statistikave dhe që ASK të jetë institucioni statistikor kryesor-udhëheqës i Kosovës. Kjo do të arrihet përmes përkushtimit të përhershëm në përmirësimin e metodologjisë, standardeve dhe paraqitjes statistikore në përputhje me nevojat e përdoruesve kryesorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të statistikave të Kosovës. Misioni është të përmbushë nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore cilësore, të besueshme dhe objektive. Prioritetet e mëtejshme janë përcaktuar në programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare që përshkruan zhvillimet e sistemit statistikor me objektivin e përgjithshëm për të arritur një sistem statistikor të qëndrueshëm dhe të besueshëm dhe të punojë drejt përmirësimit të produktivitetit dhe cilësisë së prodhimit.

Struktura e IKS-së dhe e Sistemit Kombëtar të Statistikave

ASK-ja menaxhohet nga KE i cili emërohet sipas procedurës së punonjësve të lartë civilë në Ligjin për Shërbimin Civil. Megjithatë, roli dhe detyrat e KE-së përshkruhen në Ligjin për Statistikat Zyrtare.

ASK-ja është e organizuar në shtatë departamente; katër prej tyre janë departamente horizontale, ndërsa tre janë departamente për prodhimin e statistikave. Çdo departament përbëhet nga 1 deri në 3 divizione. Shtatë zyra rajonale kryejnë dhe mbikëqyrin mbledhjen e të dhënave. Prej 149 pozitave të punës të miratuara, 99 nëpunës aktualisht janë të punësuar në zyrën qendrore dhe 46 janë të punësuar në zyrat rajonale dhe 4 pozita janë në proces të rekrutimit. ASK-ja e konsideron si të ulët nivelin e saj të burimeve, si në aspektin e buxhetit ashtu edhe në numrin e pozitave.

Këshilli i Statistikave përbëhet nga 13 anëtarë duke përfshirë Kryeshefin Ekzekutiv të ASK-së, institucionet e ndryshme publike që përfaqësojnë përdoruesit dhe ofruesit e të dhënave, Autoritetet e tjera Kombëtare (AtK), akademia, shoqëria civile dhe komuniteti i biznesit. Përbërja, funksionet dhe organizimi i Këshillit të Statistikave përshkruhet në Ligjin për Statistikat Zyrtare si dhe në rregulloren e Këshillit të Statistikave. Përgjegjësia kryesore e Këshillit të Statistikave është të këshillojë në përgatitjen e programeve të punës statistikore, planet vjetore dhe në zhvillimin dhe funksionimin e përgjithshëm të ASK-së dhe të këshillojë për harmonizimin dhe koordinimin e produkteve statistikore brenda Sistemit Statistikor të Kosovës. Vlerësimi dhe monitorimi i planeve vjetore kryhen edhe nga Këshilli i Statistikave.

ASK-ja i konsideron si detyra kryesore: përgatitjen e programeve statistikore të punës, koordinimin e aktiviteteve në kuadër të sistemit statistikor, përgatitjen dhe përcaktimin e instrumenteve për anketime statistikore, dhënien e këshillave metodologjike, këshillimi për ndryshimin dhe plotësimin e grupeve ekzistuese të të dhënave dhe përmirësimin e përmbajtjes së grupeve ekzistuese të të dhënave dhe të atyre të reja në përputhje me Ligjin për Statistikat Zyrtare dhe Programin e Anketave Statistikore, bashkëpunimin me AtK-të, përgatitjen e standardeve statistikore, përcaktimin e nevojave për të dhëna statistikore, përcaktimin e masave organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, analizimin e të dhënave statistikore, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore, përmbushjen e

detyrimeve ndërkombëtare në fushën e statistikave dhe koordinimin e transmetimit të të dhënave statistikore në Eurostat dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Përveç koordinimit të programeve të punës statistikore, Ligji për Statistikat Zyrtare e definon ASK-në si institucion koordinues të sistemit statistikor në Kosovë dhe është përgjegjës për harmonizimin e statistikave zyrtare. Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Ministria e Financave (MeF) dhe "organet e tjera të autorizuar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të përcaktuara nga programi" janë definuar si ATK, sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare. ASK-ja është përgjegjëse për përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimeve dhe standardeve për prodhimin e statistikave zyrtare.

Programi Statistikor

ASK-ja e udhëheq punën për përgatitjen e programeve pesëvjeçare të punës statistikore. Prioritet i përgjithshëm i programit është që të ofrojë të dhëna statistikore për të mbështetur politikat e institucioneve të Kosovës, politikat e BE-së, vendimmarrjen dhe matjen e fenomeneve ekonomike, sociale dhe mjedisore dhe të mbajë kontakt të ngushtë dhe bashkëpunim me aktorët relevantë për të përmirësuar cilësinë, krahasueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e Statistikave Zyrtare. Derisa programi aktual mbulon periudhën 2013-2017, ASK-ja është në procesin e përgatitjes së Programit për periudhën 2018-2022. Këshilli i Statistikave konsultohet mbi programin para se të miratohet nga Qeveria.

Bazuar në programin pesëvjeçar, ASK-ja përgatit Planin Vjetor të Punës i cili në anën tjetër operohet në hartat vjetore për ASK-në. Procesi i planifikimit të ASK-së bazohet në të ashtuquajturin "Planifikim të ciklit". Zbatimi i programeve të punës statistikore monitorohet dhe paraqitet në raportet vjetore. Derisa programi pesëvjeçar përfshin aktivitetet e të gjithë prodhuesve të statistikave zyrtare, raportet vjetore mbulojnë vetëm aktivitetet e zbatuara nga ASK-ja.

Objektivat kryesorë të programit për periudhën 2013-2017 përfshijnë riorganizimin e ASK-së dhe forcimin e proceseve e saj të planifikimit, fitimet vjetore të produktivitetit në rangun 3-5 për qind dhe shkurtimin e afateve të publikimit dhe zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të saj.

Produktet statistikore

Produktet statistikore të ASK-së, mbulojnë statistikën ekonomike, sociale, bujqësore dhe mjedisore. Janë publikuar disa botime ndër-sektoriale ku ka kombinime të të dhënave nga fusha të ndryshme, si për shembull: libri vjetor i statistikave dhe buletini tremujor.

Objektivi kryesor i aktiviteve të shpërndarjes së ASK-së është të ofrojë produkte dhe shërbime që plotësojnë nevojat e përdoruesve me statistikën zyrtare. ASK-ja ka publikuar politikën e shpërndarjes e cila bazohet në parimet e pavarësisë, qasjes, besueshmërisë dhe rëndësisë, të gjitha me qëllim të krijimit të koherencës dhe relevancës për përdoruesit.

ASK-ja, publikon statistika në faqen e saj të internetit, bazën e të dhënave "ASKdata"⁴, e cila bazohet në PX-Ueb, në formë të shtypur dhe në mediat sociale. Faqja e internetit e ASK-së, e ri-dizajnuar kohët e fundit, po bëhet burimi bazë i statistikave zyrtare ku publikimet janë organizuar në fusha tematike. Secili publikim mbulon një përshkrim përmbledhës ose një pjesë të vogël analitike, dokumentacion metodologjik dhe i referohet të dhënave të hollësishme që gjenden në bazën e të dhënave. Baza e të dhënave ofron njëfarë fleksibiliteti në aspektin e formateve, llogaritjeve dhe mënyrës së paraqitjes së të dhënave.

⁴ PX-Ueb është zgjidhje për të krijuar tabela dinamike në internet dhe përdoret nga shumë IKS. Shiko: http://ëëë.scb.se/sv_/PC-Axis/Programs/PX-Ëeb/

Të gjitha publikimet e ASK-së para-shpallen në kalendarin e publikimit, i cili gjithashtu shënon vonesat e mundshme të publikimit. Të gjitha produktet lëshohen në orën 14 në datën e publikimit dhe nuk ka qasje të privilegjuar para kohës së lëshimit.

ASK-ja, gjithashtu, trajton kërkesat e veçanta të përdoruesve, siç janë pyetjet rreth të dhënave ose lidhur me mbledhjen e veçantë të të dhënave, nëpërmjet një pike qendrore të kontaktit në ASK. Përveç kësaj, hulumtuesit mund të aplikojnë për qasje në mikro-të dhëna, duke përdorur një procedurë standarde në formë të shkruar. Rregullat dhe protokollet për qasje të tillë janë dhënë në LSZ.

3. PËRPUTHSHMËRIA ME KODIN E PRAKTIKËS DHE ROLI I BASHKËRENDIMIT BRENDA SISTEMIT KOMBËTAR TË STATISTIKAVE

3.1 FUQITË E INSITUTIT KOMBËTAR TË STATISTIKAVE NË LIDHJE ME PËRPUTHJEN E SAJ ME KODIN E PRAKTIKËS DHE ME ROLIN BASHKËRENDUES

Kjo pjesë e raportit identifikon disa aspekte të KOP-it në lidhje me të cilat ASK-ja, nga Ekipi i "Peer Review", konsiderohet të ketë treguar standarde të larta në lidhje me përputhshmërinë me KoP-in.

Kuadri ligjor i Sistemit Kombëtar Statistikor të Kosovës - kryesisht Ligji për Statistikat Zyrtare - është gjithëpërfshirës dhe mbulon fushat kryesore që rregullojnë statistikave zyrtare në BE. Hyri në fuqi në vitin 2011, duke përfutuar nga modelet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Parimet që rregullojnë statistikave zyrtare në Kosovë, siç parashikohet në nenin 3, janë të përafërta me KoP. Neni 6 i Ligjit parashihet që: *"ASK është institucion i pavarur, profesional dhe bartës, shpërndarës dhe koordinator i sistemit statistikor të Kosovës, që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM)".* Qasja në burimet administrative i jepet ASK-së me nenin 7: *"... Gjatë kryerjes së detyrave të veta, ASK-ja ka të drejtë (...) të kërkojë të dhëna administrative dhe statistikore nga ministritë dhe institucionet e tjera (...) Të gjitha njësitë e institucioneve janë të obliguara të ofrojnë të dhëna statistikore të parashikuara në këtë nen, përveç nëse parashihet ndryshe me ndonjë akt tjetër ligjor".*

Bazuar në intervistat e kryera gjatë vizitës së ekspertëve, Ekipi i "Peer Review" formoi mendimin se ASK-ja respektohet dhe konsiderohet si e pavarur profesionalisht dhe prodhon statistika të cilësisë së mirë. Statistikat e prodhuara nga ASK-ja sfidohen rrallë dhe në rast keqpërdorimi ose keqinterpretimi, përgjigjet e siguruara nga ASK-ja janë të mjaftueshme për të sqaruar ndonjë keqkuptim ose çështje të paqartë.

Siç parashikohet në Ligjin për Statistikat Zyrtare, Programi pesëvjeçar i statistikave zyrtare hartohet nga ASK-ja me rekomandim të Këshillit të Statistikave dhe në përputhje me Programin Statistikor të Bashkimit Evropian. ASK-ja përdor sistem gjithëpërfshirës (SIPK) për të regjistruar kohën e shpenzuar nga stafi në çdo aktivitet, duke mundësuar programimin më të mirë të aktiviteteve të programit në baza vjetore. Sistemi identifikon projektet dhe hapat që korrespondojnë me fazat kryesore të Modelit për procesin gjenerik të statistikave të biznesit (GSBPM).

Duke përfutuar nga madhësia relativisht e vogël, vetëm 149 anëtarë të stafit, ASK-ja zhvilloi një menaxhim pjesëmarrës dhe një atmosferë të mirë pune, siç u vëzhgua nga Ekipi i "Peer Review" gjatë takimeve, duke përfshirë edhe me stafin më të ri. Kjo i mundëson ASK-së të inkurajojë iniciativat nga stafi pavarësisht nga pozicioni i tyre në institucion. Stafi i ri është i kualifikuar mirë dhe i përkushtuar ndaj punës së tyre dhe ka shprehur besimin në ndërtimin e karrierës në ASK.

Duke përdorur dispozitat e Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja, në periudhë të shkurtër, ka arritur që të dhënat administrative t'i përdor në mënyrë të gjerë, duke nënshkruar tashmë më shumë se 15 memorandume mirëkuptimi me ofruesit e ndryshëm të të dhënave administrative, që korrespondojnë me pothuajse 30 seri administrative. ASK-ja ka zhvilluar bashkëpunim të ngushtë me këta ofrues të të dhënave administrative përmes grupeve punuese në mënyrë që të shkëmbejë karakteristikat teknike të këtyre burimeve.

Me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), ASK-ja e ka zhvilluar faqen e internetit të re, moderne dhe tërheqëse, të vlerësuar në mënyrë unanime nga përdoruesit e Ekipit të "Peer Review" të intervistuar. Faqja e internetit e ASK-së ofron qasje të përdorimit-miqësor tek njoftimet për shtyp dhe publikimet. Përveç kësaj, përdoruesit mund të shfrytëzojnë tabelat statistikore dhe të kenë qasje tek hartat interactive (ndërvepruese). Të gjitha

publikimet dhe njoftimet për shtyp publikohen në mënyrë sistematike në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, duke mundësuar shikueshmëri të madhe ndërkombëtare.

ASK-ja gjithashtu emëroi një zyrtar për komunikim për të shërbyer si pikë qendrore për mediat. Gazetarët e intervistuar nga Rishikuesit shprehën kënaqësinë e tyre për qasje të lehtë në informata dhe tek ekspertët e ASK-së përmes këtij personi.

Në përgjithësi, Ekipi i "Peer Review" arriti në përfundimin se ASK-ja, duke pasur parasysh se është IKS relativisht e re, ka arritur shumë dhe është në shumicën e aspekteve në përputhje me KoP-in. Fushat e dobësive kryesisht janë të lidhura me burimet e saj njerëzore të cilat janë ende të pamjaftueshme për të kryer detyrimet e saj për të prodhuar statistika zyrtare dhe për zhvillimin e një menaxhimi cilësor të shpërndarë gjerësisht.

3.2 ÇËSHTJET DHE REKOMANDIMET

Kjo pjesë paraqet çështjet ku Ekipi i "Peer Review" vlerëson se niveli i përgjithshëm i përputhshmërisë së tërë SKS me KoP-in mund të rritet:

- Konsolidimi i kuadrit ose kornizës institucionale
- Rritja e burimeve dhe përmirësimi i efektivitetit të kostos;
- Zhvillimi i menaxhimit të cilësisë dhe metodologjisë
- Forcimi i marrëdhënieve me përdoruesit.

Këto çështje diskutohen me rekomandime specifike në pjesët vijuese të raportit.

3.2.1 KONSOLIDIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL

Gjatë viteve të fundit, ASK-ja ka qenë në procesin e zhvillimit edhe të kuadrit për prodhimin e statistikave zyrtare edhe të portofolit të produkteve statistikore. Zhvillimi i mëtejshëm i prodhimit të tij statistikor është i nevojshëm për të përmbushur nevojat e përdoruesve kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Pasi që ASK-ja dhe sistemi statistikor në Kosovë janë relativisht të rinj dhe ende institucione në zhvillim, në krahasim me shumë vende të tjera evropiane, ASK-ja mund të përfitojë nga situata aktuale në mënyrë që të vendos autoritetin dhe kapacitetin institucional si koordinatori i sistemit statistikor.

Ekipi i "Peer Review" identifikoi tre fusha ku ASK mund që më tej të përmirësoj kuadrin institucional dhe rolin e vet koordinues:

- Forcimi i kuadrit ligjor;
- Forcimi i zbatimit të parimeve të konfidencialitetit;
- Përmirësimi i koordinimit.

3.2.1.1 FORCIMI I KUADRIT LIGJOR

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Statistikat Zyrtare në vitin 2011, ASK-ja propozoi ndryshim-plotësime të mëtejshme në vitin 2016 me qëllim të harmonizimit të legjislacionit me KoP-in, dhe në veçanti me treguesit që kanë të bëjnë me parimin e pavarësisë profesionale. Derisa ndryshim-plotësimi fillestar propozoi zgjatjen e mandatit të kryeshefit ekzekutiv, konsultimet pasuese me Qeverinë dhe Kuvendin rezultuan në diskutime, nëse Agjencia duhet të jetë në varësi të Zyrës së Kryeministrit, Kuvendit të Kosovës apo Ministrisë. Derisa disa situata gjenden në SES, marrëveshja që zgjedhet duhet të ketë parasysh ruajtjen e pavarësisë profesionale të Agjencisë, pavarësisht nga organizimi i saj në sektorin publik.

Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv, procedura e emërimit dhe arsyet mbi bazën e të cilave mund të ndërpritet funksioni aktual, aktualisht mbulohen nga Ligji për Shërbimin Civil. Sipas këtij ligji, mandati është 3 vjet dhe i rinovueshëm. Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e programit pesëvjeçar të punës, i cili përcakton prioritetet afatmesme të Agjencisë, mandati i Kryeshefit Ekzekutiv duket relativisht i shkurtër. Zgjatja e mandatit të KE-së do t'i lejonte KE-së të zbatojë prioritetet afatgjata dhe t'i japë stabilitet menaxhimit të lartë që do të përfitonte një institucion i cili është duke u zhvilluar.

Ekipi i "Peer Review" e konsideron kuadrin ligjor mjaft të qartë sa i përket rolit dhe përgjegjësisë së Agjencisë në drejtim të këshillimit dhe vendosjes së metodologjisë përkatëse statistikore. Në mënyrë të ngjashme, roli i KE-së në menaxhimin dhe administrimin e ASK-së dhe në prodhimin statistikor duket i qartë. Megjithatë, autoriteti metodologjik në sistemin statistikor nuk është i qartë për rolin e Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së. Rregullorja e ndryshuar kohët e fundit 223/2009 mbi Statistikat Evropiane, dhe më pas ndryshimi i legjislacionit kombëtar në disa IKS, sqaron përgjegjësinë metodologjike në sistemin statistikor që i përket ekskluzivisht Drejtorit të Përgjithshëm të IKS, i cili shpesh titullohet "Statisticianti Kryesor" ose "Statisticianti Kombëtar". Forcimi i këtij aspekti të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare do të theksonte rolin e Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së edhe në çështjet e metodologjisë.

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja ka mandat për qasje dhe përdorim të të dhënave administrative për qëllime statistikore. Ekipi i "Peer Review" morri parasysh përdorimin e gjerë të të dhënave administrative si një nga pikat e forta të ASK-së. Meqenëse Agjencia është në proces të zgjerimit gradual të përdorimit të të dhënave administrative, sidomos në fushën e statistikave sociale dhe demografike, Ekipi i "Peer Review" konsideron se ASK-ja do të forconte qëndrimin e saj me dispozita specifike në Ligjin për Statistikat Zyrtare me të drejtën që të përfshihet në hartimin dhe zhvillimin e të dhënave administrative. Kjo gjithashtu do të ruante prodhimin e statistikave zyrtare në situatat ku ASK-ja varet kryesisht nga të dhënat administrative.

Për të forcuar më tej kuadrin ligjor të ASK-së, **Ekipi i "Peer Review" rekomandon që:**

- 1. Rishikimi i ardhshëm i Ligjit të Kosovës për Statistikat Zyrtare duhet të ketë parasysh ruajtjen e pavarësisë profesionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe të deklarojë se kreu i Agjencisë është përgjegjës i vetëm për të vendosur mbi metodat, standardet dhe procedurat statistikore, duke zgjeruar mandatin e tij / saj në një periudhë më të gjatë se aktualisht. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesit 1.3 dhe 1.4.)**
- 2. Ligji i Kosovës për Statistikat Zyrtare duhet të përmbajë dispozita specifike mbi të drejtën e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për t'u përfshirë në hartimin e regjistrave administrative që përdoren ose mund të përdoren për qëllime statistikore, dhe të konsultohet për ndryshimet dhe shuarjen ose mbylljen e këtyre regjistrave dhe shënimeve administrative. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 2.)**

3.2.1.2 FORCIMI I ZBATIMIT TË BESUESHMËRISË

Janë vendosur disa masa institucionale për të mbrojtur të dhënat e besueshme nga pikëpamja teknike dhe ligjore. Për shembull, besueshmëria ose konfidencialiteti sigurohet në mënyrë eksplicite në Ligjin për Statistikat Zyrtare dhe legjislacionin tjetër lidhur me mbrojtjen e të dhënave në Kosovë. Një shembull tjetër është mënyra si ASK siguron masat e përshtatshme të IT-së për të mbrojtur të dhënat.

Derisa korniza për sigurimin e besueshmërisë është përgjithësisht në vend, Ekipi i "Peer Review" konsideron se zbatimi i parimeve të besueshmërisë mund të forcohet. Derisa besueshmëria

përshkruhet në politikën e shpërndarjes (diseminimit), nuk ekziston një politikë e veçantë e besueshmërisë e vendosur në ASK. Kontratat e punës ndërmjet ASK-së dhe stafit të saj (të cilat janë të përgjithshme për sektorin publik në Kosovë) përmbajnë një paragraf të veçantë për respektimin e besueshmërisë; megjithatë, stafi nuk është i detyruar të nënshkruajë një angazhim të veçantë mbi besueshmërinë me rastin e punësimit të tyre në ASK. Një fushë tjetër që Ekipi i "Peer Review" e merr parasysh është zbatimi i besueshmërisë statistikore që mund të forcohet ndaj ofruesve kryesorë të të dhënave. ASK-ja i informon të anketuarit në lidhje me besueshmërinë e të dhënave të ofruara, në letrat për të anketuarit dhe në Memorandumet e Mirëkuptimit me ofruesit e të dhënave administrative. Sidoqoftë, ASK-ja mund të marrë masa të mëtejshme për të siguruar dhe informuar në mënyrë aktive ofruesit e saj të të dhënave administrative se si zbatohen parimet e besueshmërisë dhe gjithashtu duke i siguruar që përgjigjet ose komentet e dhëna nga ofruesit e të dhënave administrative e respektojnë besueshmërinë.

Forcimi i disa elementeve të mënyrës se si ASK-ja zbaton dhe informon stafin e vet dhe ofruesit e të dhënave për besueshmërinë ose fshehtësinë statistikore do të kontribuojë në ndërtimin e një kulture më të fortë të besueshmërisë në ASK. Kjo gjithashtu ka gjasa të zvogëlojë rrezikun e zbulimit të të dhënave të fshehta dhe do të forcojë imazhin e ASK-së ndaj ofruesve dhe përdoruesve të të dhënave të saj.

Për të forcuar zbatimin e besueshmërisë statistikore dhe për të rritur përputhshmërinë me KoP-in, Ekipi i "Peer Review" rekomandon që:

- 3. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të forcojë kulturën e korporatës mbi besueshmërinë duke bërë që stafi i saj të kuptojë dhe të angazhohet plotësisht për të zbatuar besueshmërinë statistikore. Për më tepër, ASK-ja duhet të garantojë ofruesit kryesorë të të dhënave për zbatimin e besueshmërisë statistikore. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 5.)**

3.2.1.3 PËRMIRËSIMI I KOORDINIMIT

Ekipi i "Peer Review" pranon se janë krijuar disa mekanizma për të lehtësuar bashkërendimin ose koordinimin e sistemit statistikor në Kosovë. Ligji mbi Statistikat Zyrtare përcakton sistemin statistikor kombëtar me ASK-në si institucion udhëheqës dhe koordinues. AtK-të përfshijnë BQK-në, MeF-në dhe autoritetet e tjera të autorizuara në programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare⁵.

Përveç mekanizmave koordinies të vendosur në nivel operacional, si dhe në dokumentet strategjike siç janë programet e punës, ASK-ja mund t'i ofrojë AtK-ve shikueshmëri në sistemin statistikor në faqen e saj. Ky është gjithashtu një kanal për të promovuar fushëveprimin e SKS dhe produktet e publikuara nga AtK-të. Një pjesë e rolit koordinues të ASK-së është të përcaktojë metodologjinë e përshtatshme dhe një sërë standardesh statistikore që do të përdoren për prodhimin e statistikave zyrtare. Sigurimi i një informacioni të tillë, për shembull, klasifikimet standarde, në faqen e internetit të ASK-së, jo vetëm që do të ishte një mënyrë për të promovuar ASK-në si autoritet kryesor kur është fjala për statistikave zyrtare, por gjithashtu mund të konsiderohet si mënyrë për të mbështetur AtK-të duke ofruar standarde për sistemin kombëtarë statistikor.

Janë krijuar një numër i grupeve të punës ndër-agjencionale, disa janë grupe të rregullta që mbulojnë një sektor apo anketë të veçantë, ndërsa të tjerat janë krijuar kur janë ndërmarrë veprime të mëdha statistikore (siç është Regjistrimi i Bujqësisë dhe rishikimi i NVE ose NACE). Këto grupe

⁵ Programi i statistikave zyrtare 2013-2017 liston 6 ministri si "ofrues të tjerë" të statistikave zyrtare në Kosovë.

janë mekanizma të rëndësishëm koordinimi, dhe ASK-ja mund të krijojë dhe të mbajë një listë të grupeve të punës ndërmjet agjencive dhe të raportojë për punën e tyre.

Neni në LSZ që përcakton prodhuesit e statistikave zyrtare lejon që institucione shtesë të autorizohen për të prodhuar statistika zyrtare në programet e punës statistikore. Megjithatë, kriteret për t'u kualifikuar si prodhues i statistikave zyrtare nuk janë të qarta. Për më tepër, pa kriteret të qarta nuk është e mundur të vlerësohet përputhshmëria e AtK-ve me këto kriteret. Shumë vende definojnë statistikat zyrtare në dy nivele: së pari nga institucioni prodhues dhe së dyti duke emëruar ose etiketuar produkte të caktuara statistikore si statistika zyrtare. Përveç kësaj, është e zakonshme që të vendosen kriteret bazuar në parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane për t'u kualifikuar si prodhues i statistikave zyrtare, posaçërisht sa i përket standardeve të cilësisë. Institucioni udhëheqës shpesh koordinon AtK-të në aspektin e dokumentimit të cilësisë dhe të meta të dhënave.

Ekipi i "Peer Review" konsideron se duhet të krijohet një mekanizëm, ndoshta një komitet koordinimi i bashkangjitur Këshillit të Statistikave, për të përmirësuar këtë aspekt të koordinimit dhe për të monitoruar në mënyrë sistematike përputhshmërinë e AtK-ve.

Pasi që ASK-ja dhe sistemi statistikor në Kosovë janë relativisht të rinj dhe ende institucione në zhvillim në krahasim me shumë vende të tjera evropiane, ASK-ja duhet të përfitojë nga situata aktuale për të vendosur autoritetin e saj si koordinator i sistemit statistikor kombëtar.

Për të forcuar rolin e saj koordinues, **Ekipi i "Peer Review" rekomandon që:**

- 4. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të përforcojë rolin e saj bashkëndues në Sistemin Kombëtar të Statistikave duke i mundësuar Autoriteteve të tjera Kombëtare dhe Sistemit Kombëtar të Statistikave që të kenë shikueshmëri në faqen e saj të internetit dhe të shkëmbejnë standardet statistikore relevante për prodhimin e Statistikave Zyrtare, siç janë klasifikimet. (Koordinimi)**
- 5. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të qartësojë përkufizimin e Statistikave Zyrtare duke përcaktuar një sërë kriteresh të bazuara në KoP dhe krijimin e një mekanizmi për vlerësimin sistematik të përputhshmërisë me këto kriteret nga të gjitha AtK-të relevante. Një Komitet i Posaçëm Koordinues i bashkangjitur Këshillit të Statistikave mund të krijohet me mandatin për të vlerësuar përputhshmërinë me kriteret e kërkuara për t'u kualifikuar si prodhues i Statistikave Zyrtare. (Koordinimi, Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 14.)**

3.2.2 RRRITJA E BURIMEVE DHE PËRMIRËSIMI I EFIKTIVITETIT TË KOSTOS

ASK, si Institut i ri Kombëtar i Statistikave, po përballet me mungesë të rëndësishme burimesh për të përmbushur detyrimet e saj kombëtare dhe ndërkombëtare, siç është Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-në (MSA). Ekipi i "Peer Review" ka formuar mendimin se rritja e burimeve të alokuara për ASK-në është me rëndësi të madhe për ASK-në.

Ekipi i "Peer Review" identifikoi tri fusha të përmirësimeve lidhur me burimet dhe kapacitetin:

- Sigurimi i burimeve të qëndrueshme;
- Konsiderimi i transferimit të pozitave nga zyrat rajonale në selinë qendrore;
- Zhvillimi i trajnimit të brendshëm.

3.2.2.1 SIGURIMI I BURIMEVE TË QËNDRUESHME

Derisa burimet financiare të ASK-së janë rritur rregullisht gjatë viteve të fundit (+6.4 për qind në 2015, + 3.2 për qind në 2016 dhe +5.4 për qind në 2017), resurset janë ende të pamjaftueshme për të mbuluar gamën e aktiviteteve statistikore që ASK duhet të kryejë. ASK-ja ka 149 pozita të aprovuara dhe 143 të plotësuara aktualisht, ndër të cilat 97 me diplomë fakulteti.

Edhe pse situata e ASK-së ndoshta nuk është më e keqe në krahasim me institucionet e tjera publike të Kosovës, kjo kufizon seriozisht kapacitetin e saj për të përmbushur programin e statistikave zyrtare, si dhe për t'iu përgjigjur nevojave të përdoruesve për informacion. Për të kapërcyer mungesën e burimeve, ASK-ja ka zhvilluar përdorimin e gjerë të burimeve administrative. Sidoqoftë, disa fusha statistikore ende nuk mbulohe, ose nuk mbulohe siç duhet. Për periudhën afatmesme 2017-2019, ASK-ja planifikon të realizojë objektivat e përgjithshme të mëposhtme: (i) përmirësimi i sistemit statistikor dhe rezultateve statistikore, (ii) përmbushja e standardeve të BE-së dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për prodhimin e statistikave, dhe) zbatimi i MSA-së me BE-në. Për të arritur këto objektiva, ASK-ja ka identifikuar nevojën për 48 pozita të reja, në veçanti për të përmirësuar cilësinë dhe afatin kohor të rezultateve statistikore; për të zhvilluar prodhimin e statistikave në fusha të tilla si llogaritë kombëtare, statistikat e biznesit, statistikat e turizmit, statistikat sociale (EU-SILC, AFP); për të zbatuar klasifikimet e përditësuara si ISCO dhe ISCED; për të zhvilluar statistikat e bujqësisë dhe mjedisit në përputhje me rregulloret e BE-së dhe për të zbatuar sistemin e menaxhimit të metadatave të Strukturës së Metadatave Euro-SDMX (ESMS).

Ekipi i "Peer Review" e ka parasysh që ndoshta është e vështirë për Qeverinë që të sigurojë rritje të tillë të burimeve në një vit të vetëm buxhetor, por ka formuar mendimin se pa një nivel të mjaftueshëm burimesh, ASK-ja përballet me rrezikun që të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e veta lidhur me nevojat kombëtare në statistikat zyrtare, si dhe me agjendën e BE-së. Ekipi i "Peer Review" konsideron se ASK-ja duhet të rrisë më tej efikasitetin e tyre në kosto, Ekipi i "Peer Review" gjithashtu konsideron që ASK-ja duhet të ketë resurse të përshtatshme.

Për të përmirësuar më tej përputhshmërinë me KoP-in, Ekipi i "Peer Review" rekomandon që:

- 6. Autoritetet kombëtare të Kosovës duhet të sigurojnë burime adekuate për t'i mundësuar Agjencisë së Statistikave të Kosovës që të përmbushë detyrimet e saj kombëtare dhe ndërkombëtare. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 3.)**

3.2.2.2 MARRJA PARASYSH E TRANSFERIMEVE NGA ZYRAT RAJONALE NË SELINË QENDRORE

Në mesin e 149 vendeve të punës në ASK, 101 janë në selinë e Prishtinës dhe 48 në 7 zyrat rajonale. Roli i zyrave rajonale është të kryejë dhe mbikëqyrë aktivitetet e mbledhjes së të dhënave, të kryera ose nga anketuesit si personel i përhershëm ose të kontraktuar në kompani private. Ekipi i "Peer Review" formoi mendimin se një përqindje e tillë e stafit (një e treta) e ndarë për zyrat rajonale duket mjaft e shpërpjesëtuar në lidhje me mungesën e stafit në selinë qendrore e cila është e nevojshme për të hartuar dhe zbatuar rezultatet statistikore që ASK-ja kërkohet të prodhojë. Madhësia e vogël e zyrave rajonale, që përbëhet nga një menaxher dhe rreth 5 anketues mesatarisht, mund të sjellë kosto shtesë të funksionimit si dhe produktivitet më të ulët krahasuar me ato më të mëdha. Përveç kësaj, shtatë zyra rajonale në një vend prej 1.8 milionë banorësh dhe 10,908 km² tingëllojnë të tepruara krahasuar me vendet e tjera evropiane.

Zbatimi i teknologjive të reja për mbledhjen e të dhënave, siç është përdorimi i pyetësorëve të uebit, në veçanti për bizneset, duhet të zvogëlojë nevojën për mbledhjen e drejtpërdrejtë të të dhënave dhe të lirojë burimet në zyrat rajonale. Kjo do të paraqes mundësinë për të rialokuar pozitat në selinë qendrore në ASK për aktivitetet statistikore të nivelit më të lartë të cilat janë shumë të nevojshme

në ASK, duke përfshirë plotësimin e disa nga 48 pozitave që ASK-ja i ka identifikuar për të përmbushur detyrimet e saj kombëtare dhe evropiane.

Për të përmirësuar më tej përputhshmërinë me KoP-in përmes efikasitetit të organizimit të saj,

Ekipi i “Peer Review” rekomandon që:

- 7. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të vazhdojë të monitorojë ngarkesën e punës dhe produktivitetin e zyrave të saj rajonale në mënyrë që të lirojë burimet potenciale të disponueshme për t'u rialokuar për aktivitete të tjera në selinë e saj qendrore. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Parimi 10.)**

3.2.2.3 ZHVILIMI I TRAJNIMIT TË BRENDSHËM

ASK-ja ka përfituar nga trajnimi intensiv nga Eurostat dhe nga bashkëpunimi institucional me Statistikat e Suedisë në mënyrë që të mbështes përmirësimin e saj me nivelin e statistikave evropiane. Trajnimi u pranua nga ekspertë të huaj në llogaritë kombëtare, statistikave e bujqësisë, statistikave e biznesit, statistikave sociale, IT, cilësinë, metadatat dhe të tjera. Gjithsej 118 aktivitete të të gjitha llojeve u mbështetën nga programi i Ndihmës për Para-Anëtarësim (IPA2014) në vitin 2016. Personeli i trajnuar aktualisht është duke përdorur njohuritë e fituara gjatë trajnimit në punën e tyre të përditshme. Kjo paraqet kapacitet të rëndësishëm që ASK-ja duhet ta vlerësojë dhe ta shfrytëzojë për të zhvilluar trajnimin e brendshëm. Për shembull, trajnimi i marrë në menaxhimin e cilësisë dhe sistemin e menaxhimit të meta të dhënave (p.sh. ESMS) mund të kryhet brenda vendit në vend që të mbështetet në trajnimin e jashtëm.

Përveç kësaj, asnjë trajnim specifik nuk është i organizuar për të punësuarit e ri, veçanërisht për çështje të tilla si besueshmëria, sistemi ligjor apo organizimi i brendshëm. ASK-ja duhet të zhvillojë modul specifik të trajnimit për të punësuarit e ri për të siguruar që i gjithë stafi është i informuar mirë për rregullat nën të cilat ata do të veprojnë si anëtarë të stafit të ASK-së.

Përfundimisht, ndërsa ASK-ja bën përpjekje të rëndësishme për të publikuar botimet e veta në gjuhën angleze, stafi ka mungesë të aftësive të gjuhës angleze, gjë që pengon pjesëmarrjen e tyre në ngjarje ndërkombëtare, siç janë trajnimet, seminarët ose punëtoritë. Trajnimi i gjuhës angleze duhet të propozohet sistematikisht tek stafi dhe duhet të jetë në nivel lokal.

Për të përmirësuar më tej përputhshmërinë me KoP-in për të zhvilluar kapacitetin e stafit,

Ekipi i “Peer Review” rekomandon që:

- 8. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të synojë rritjen e kapaciteteve të stafit të saj duke zhvilluar një program trajnimi të brendshëm, duke u bazuar në trajnimin e gjerë tashmë të ofruar nga organizatat ndërkombëtare. (Kodit i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesi 7.6.)**

3.2.3 ZHVILLIMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË DHE METODOLOGJISË

ASK-ja ende ka hapësirë të konsiderueshme për të përmirësuar proceset statistikore. Potencialet për përmirësime janë identifikuar veçanërisht në fazën e mbledhjes së të dhënave, por edhe në përdorimin e mjeteve për mbështetjen e procesit të prodhimit statistikor në përgjithësi. Për më tepër, zgjerimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë brenda ASK-së duhet të ketë prioritet të qartë. Ekipi i “Peer Review” identifikoi katër fusha ku ASK-ja duhet të përmirësojë menaxhimin e cilësisë dhe metodologjinë:

- Forcimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë;

- Monitorimi dhe kontrollimi i punës së anketuesve;
- Rritja e përdorimit të pajisjeve elektronike për mbledhjen e të dhënave;
- Angazhimi në zhvillimin e moduleve GSBPM.

3.2.3.1 FORCIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË

ASK-ja është e vetëdijshme për rëndësinë e cilësisë së lartë të proceseve dhe produkteve statistikore për t'i shërbyer nevojave dhe për të ruajtur besimin e përdoruesve në fushat e politikës, administratës publike, biznesit, komunitetit shkencor dhe publikut të gjerë. Përgjegjësia qendrore për çështjet e cilësisë i caktohet Menaxherit të Cilësisë dhe Grupit Drejtues të Cilësisë, i themeluar në vitin 2014. ASK-ja ka zhvilluar një Deklaratë të Cilësisë e cila është në dispozicion në faqen e internetit të ASK-së; dokumenti liston njëmbëdhjetë parime, shumë në përputhje me parimet e KoP-it siç është pavarësia profesionale dhe besueshmëria statistikore, në të cilat bazohet puna e ASK-së. Përputhshmëria me legjislacionin evropian dhe rekomandimet e Eurostatit shihen si siguri i rëndësishëm të produkteve statistikore.

Procedurat për të monitoruar nga brenda cilësinë e produkteve statistikore janë në përgjegjësinë e njësisë prodhuese përkatëse. Raportet e meta të dhënave në formatin ESMS janë në dispozicion për produktet e ndryshme statistikore. Në nivelin më të lartë, komunikimi me përdoruesit është fokusuar përmes Këshillit të Statistikave. Janë krijuar një numër grupesh përdoruesish, p.sh., në fushën e statistikave ekonomike, të cilat merren me diskutime më teknike. Kënaqshmëria e përdoruesit është hulumtuar në një anketë në vitin 2014.

Parimi 4 i KoP-it kërkon që autoritetet statistikore të identifikojnë sistematikisht dhe rregullisht pikat e forta dhe të dobëta në mënyrë që procesi dhe cilësia e produktit të përmirësohet vazhdimisht. Në takimet e Ekipit të "Peer Review" u vu re se sistemi i menaxhimit të cilësisë brenda ASK-së, siç është zhvilluar aktualisht, nuk është aq i plotë sa mund të ishte. Nuk ka mbulim të gjerë siç rekomandohet nga parimet e menaxhimit të cilësisë, duke mbuluar çështje të tilla si:

- Orientimi i përdoruesve, duke përfshirë aspektet e tilla si politika e komunikimit, politika e produktit dhe e marketingut, qasja në rezultate dhe monitorimi i përdorimit të rezultateve ekzistuese (KoP, Parimi 11);
- Menaxhimi i ngarkesës së të anketuarve (KoP, Parimi 9);
- Zhvillimi i stafit, duke përfshirë aspektet e tilla si trajnimi i stafit, rotacioni dhe pasurimi i punës dhe kënaqshmëria e stafit (KoP, Parimi 3).

Ekipi i "Peer Review" konkludoi se ASK-ja do të përfitonte nga zhvillimi i mëtejshëm i aranzhimeve të menaxhimit të cilësisë dhe strukturës së saj organizative në mënyrë të tillë që:

- Përgjegjësia për programin e menaxhimit të cilësisë t'i caktohet Menaxhuesit të Cilësisë i cili duhet të raportojë direkt tek Kryeshefi Ekzekutiv (KE); KE do të përfshihet në të gjitha aktivitetet e ndërlidhura;
- Grupi Drejtues i Cilësisë përfshin sistematikisht menaxhmentin e lartë dhe vepron fuqishëm në identifikimin e potencialeve për përmirësime dhe drejtimin e këtyre zhvillimeve;
- Grupet e përdoruesve për statistikat e rëndësishme do të diskutojnë nevojat e përdoruesve dhe do të japin reagime për të gjitha çështjet që lidhen me cilësinë, duke siguruar informacion rreth mundësive për përmirësime.

Nën model të tillë, Grupi Drejtues i Cilësisë do të diskutonte projektet e ndryshme duke përfshirë planin vjetor të punës, hartimin e strategjisë së menaxhimit të cilësisë dhe sigurimin e Menaxhuesit të Cilësisë me informacion mbi çështjet e cilësisë në të gjithë organizatën.

Një projekt i cilësisë duhet gjithashtu të përqendrohet në zhvillimin e udhëzimeve të cilësisë që përshkruajnë në mënyrë gjithëpërfshirëse proceset statistikore që përdoren në ASK përgjatë vijës me GSBPM, duke i mbështetur menaxhuesit për zbatimin e menaxhimit të cilësisë. Një projekt tjetër i cilësisë duhet të jetë koordinimi i prodhimit të raporteve të meta të dhënave për të gjitha produktet statistikore. Projektet e tjera duhet të merren me dimensione të ndryshme të cilësisë, p.sh., me përmirësimin e afateve kohore duke ulur më tej vonesën në prodhimin e statistikave të caktuara. Këto projekte duhet të ndihmojnë ASK-në të identifikojë potencialet për përmirësime, vazhdimisht duke fituar cilësi dhe kosto-efektivitet.

Për të rritur më tej përputhshmërinë me Parimin 4 të KoP-it, Ekipi i “Peer Review” rekomandon që:

- 9. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të krijojë një sistem më të gjerë të menaxhimit të cilësisë. Menaxhuesi i Cilësisë, një ekspert i lartë përgjegjës për cilësinë, duhet të përmbushë rolin e Koordinatorit të Cilësisë dhe të raportojë direkt tek Kryeshefi Ekzekutiv. Grupi Drejtues i Cilësisë duhet të mbështesë dhe udhëzojë Menaxhuesin e Cilësisë si një komision cilësor ndër-organizativ. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesi 4.)**

3.2.3.2 MONITORIMI DHE KONTROLLIMI I PUNËS SË ANKETUESVE

Mbledhja e të dhënave është e organizuar me përfshirjen e organizimit rajonal të ASK-së; stafi i shtatë zyra rajonale ka anketues të trajnuar dhe me përvojë që kryejnë anketa ose intervista ballë për ballë. Në përgjithësi, normat e përgjigjeve si në anketat e ekonomive familjare po ashtu edhe ato ato biznesit janë në një nivel prej rreth 80% që është mjaft i kënaqshëm.

Ekipi i “Peer Review” kishte përshtypjen se monitorimi i punës së anketuesve duhet të përmirësohet dhe kontrollimi të forcohet dhe të kryhet në mënyrë sistematike. Kjo i referohet aspekteve si sjellja e anketuesve në përgjithësi dhe dimensioneve të cilësisë në veçanti. Anketuesit duhet të trajnohen mirë dhe të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e besueshmërisë. Rolet e zyra rajonale gjithashtu duhet të qartësohen në lidhje me procedurat e kontrollimit të mbledhjes së të dhënave. Procedurat për kontrollimin e punës së anketuesve duhet të zbatohen në mënyrë sistematike; analizat e dokumentacionit të këtyre aktiviteteve duhet të përdoren për të përmirësuar proceset që lidhen me mbledhjen e të dhënave.

Për të forcuar përputhshmërinë me KoP-in, Ekipi i “Peer Review” rekomandon që:

- 10. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të krijojë procese për të monitoruar dhe kontrolluar punën e anketuesve që kryejnë punën e mbledhjes së të dhënave. Fokusi duhet të jetë në aspekte si paanshmëria, besueshmëria dhe dimensionet përkatëse të cilësisë. Rezultatet e këtij monitorimi duhet të përdoren për të përmirësuar proceset e mbledhjes së të dhënave. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesi 12.1.)**

3.2.3.3 RITJA E PËRDORIMIT TË PAJISJEVE ELEKTRONIKE PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Mbledhja e të dhënave nga ASK-ja kryesisht bëhet përmes intervistave ballë për ballë. Përdorimi i pajisjeve elektronike për mbledhjen e të dhënave, si tableti, dhe zhvillimi i proceseve për mbledhjen së të dhënave si CAPI, CATI dhe pyetësorët elektronikë janë në fazën e hershme në ASK. Për shembull, ASK-ja ka një marrëveshje me Bankën Botërore për të kryer anketa duke përdorur tableta dhe softuerin e Survey Solutions. Ekipi i “Peer Review” nuk mund të identifikojë asnjë procedurë

sistematike për shqyrtimin e potencialit për aplikime të mëtutjeshme të mbledhjes elektronike të të dhënave. Mbledhja e të dhënave me bazë në internet nga ndërmarrjet ruan besueshmërinë, zvogëlon ngarkesën e plotësimit të formularit dhe rrit efikasitetin e proceseve statistikore. Përdorimi i internetit mund të përmirësohet më tej nëse mbledhja e të dhënave të biznesit përpunohen përmes një faqe të zakonshme/përbashkët interneti. Bashkëpunimi në zhvillimin e sistemit të mbledhjes së të dhënave dhe pyetësorëve online me IKS të tjera mund të jetë i mundshëm. Të gjitha këto masa do të rrisnin kosto-efektivitetin e grumbullimit të të dhënave dhe prodhimin e statistikave me cilësi më të larta.

Për të forcuar përputhshmërinë me KoP-in, **Ekipi i “Peer Review” rekomandon që:**

- 11. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të rrisë përdorimin e pajisjeve elektronike për mbledhjen e të dhënave. Duhet të angazhohet në zhvillimin e një sistemi elektronik për mbledhjen e të dhënave. Mbledhja e të dhënave nga Intervistimi Personal i Ndihtuar me Kompjuter (CAPI), Intervistimi me Telefon i Ndihtuar në Kompjuter (CATI) dhe pyetësorët elektronikë duhet të zhvillohen në mënyrë që të fitohet efikasitet dhe të rritet cilësia e të dhënave. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesit 9.3 dhe 10.2.)**

3.2.3.4 ANGAZHIMI PËR TË ZHVILLUAR MODULET E GSBPM

Brenda ASK-së, një koncept i përgjithshëm për hartimin e procesit statistikor, si GSBPM, nuk është zbatuar në mënyrë uniforme deri më tani. GSBPM siguron kornizë standarde dhe terminologji të harmonizuar për të ndihmuar organizatat statistikore për modernizimin e proceseve të tyre statistikore të prodhimit, si dhe për të shkëmbyer metodat dhe komponentët. GSBPM gjithashtu mund të përdoret për integrimin e të dhënave dhe standardeve të meta të dhënave, si model për dokumentimin e procesit, për harmonizimin e infrastrukturës statistikore të informatizimit dhe për sigurimin e një kuadri për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së procesit. GSBPM është përdorur me sukses nga organizatat statistikore si kornizë për zhvillimin e sistemeve për prodhimin statistikor. Ai përbën një pjesë thelbësore të punës së Eurostatit për zbatimin e vizionit të SES për harmonizimin më të mirë dhe integrimin e proceseve statistikore të biznesit dhe rëndësinë e menaxhimit të meta të dhënave.

Ekipi i “Peer Review” sheh një potencial substancial për të përmirësuar proceset statistikore dhe cilësinë e produkteve statistikore duke zbatuar elementet e GSBPM. Për shembull, zhvillimi i metodologjisë së harmonizuar për kontrollimin ose redaktimin dhe imputimin, i cili është i përshtatshëm për të gjitha proceset e mbledhjes së të dhënave në ASK, thjeshton proceset e redaktimit të të dhënave, përmirëson cilësinë e të dhënave dhe redukton përpjekjet për trajnimin e personelit. Si hap i parë, proceset ekzistuese statistikore duhet të hartohen drejt GSBPM; kjo do të lejonte identifikimin e ngjashmërive të mundshme dhe zhvillimin e moduleve të përbashkëta. Për zhvillimin e moduleve GSBPM, bashkëpunimi me IKS-të e tjera mund të jetë i mundshëm. Përdorimi i moduleve GSBPM do të rriste efektivitetin e kostove të të gjithë proceseve statistikore dhe gjithashtu ka potencial për të rritur cilësinë e prodhimeve.

Për të forcuar përputhshmërinë me KoP-in, **Ekipi i “Peer Review” rekomandon që:**

- 12. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të angazhohet në zhvillimin e moduleve të Modelit për Procesin Gjenerik të Biznesit (GSBPM) në mënyrë që të rrisë efektivitetin e kostove të proceseve statistikore dhe të përmirësuar cilësinë e produkteve statistikore. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesit 8.1-8.8.)**

3.2.4 FORCIMI I MARRËDHËNIEVE ME PËRDORUESIT

Marrëdhëniet e forta me përdoruesit janë mjet i rëndësishëm për të kuptuar nevojat e përdoruesve, për të rritur rëndësinë dhe cilësinë e produkteve statistikore dhe për të rritur besueshmërinë e autoritetit statistikor. Një mjet efikas për forcimin e marrëdhënieve me përdoruesit janë grupet e përdoruesve të cilat mund të krijohen për të gjitha fushat e lëndëve, aty ku duket e përshtatshme. Një mjet tjetër që u tregua i frytshëm për shumë IKS është zhvillimi i marrëdhënieve me universitetet dhe institucionet kërkimore. Ekipi i “Peer Review” ka identifikuar dy fusha ku rekomandohet që ASK-ja të forcojë marrëdhëniet me përdoruesit:

- Krijimi i më shumë grupeve punuese sipas lëndës;
- Zhvillimi i marrëdhënieve më të forta me akademinë dhe institucionet kërkimore.

3.2.4.1 KRIJIMI I GRUPEVE PUNUESE SIPAS LËNDËS

Në pjesën "Menaxhimi i cilësisë dhe metodologjisë", është theksuar rëndësia e grupeve të përdoruesve. Grupet e përdoruesve nga politika, administrata publike, biznesi, komuniteti shkencor dhe publiku i gjerë janë burime shumë të rëndësishme të informacionit mbi nevojat e përdoruesve dhe japin reagime, p.sh., për çështjet e cilësisë që lidhen me produktet statistikore, duke ofruar informacion rreth potencialeve për përmirësim.

Ligji për Statistikat Zyrtare kërkon që ASK-ja të konsultojë përdoruesit, ndër të tjera, për programin e statistikave pesëvjeçare. Siç përcaktohet në ligj, ASK-ja ka një Këshill Statistikor anëtarët e të cilit janë shfrytëzues dhe palë të tjera të interesit të statistikave zyrtare. Nën ombrellën e Këshillit të Statistikave, ASK ka themeluar grupe punuese sipas lëndës. Për shembull, në fushën e statistikave ekonomike, grupet e përdoruesve janë aktive në llogaritë kombëtare, financat qeveritare, statistikave të energjisë, statistikave të turizmit, statistikave të tregtisë së jashtme, statistikave të prodhimit dhe regjistrin statistikor të biznesit.

Ekipi i “Peer Review” sugjeron forcimin e marrëdhënieve me përdoruesit duke krijuar sistematikisht grupe të tilla pune për të gjitha fushat tematike të rëndësishme dhe duke mbajtur takime të rregullta. Kjo do të lejojë monitorimin e relevancës dhe dobisë së statistikave ekzistuese, për të kuptuar më mirë nevojat e përdoruesve dhe për të marrë reagime në lidhje me përvojat e përdoruesve me produktet statistikore dhe me nevojat dhe prioritetet që dalin.

Orientimi i përdoruesit që shprehet në krijimin e grupeve të përdoruesve është mjet i rëndësishëm për menaxhimin e cilësisë dhe përbërës për përmirësim të vazhdueshëm.

Marrëdhëniet e mira me ekepertët-përdorues gjithashtu mund të jenë bazë për bashkëpunim. Një bashkëpunim i tillë mund të synojë, p.sh., në analizimin e përbashkët të të dhënave, ose në interpretimin e të dhënave duke plotësuar pikëpamjet e ekspertit të të dhënave me atë të ekspertit të lëndës. Analiza të tilla lejojnë një vlerë shtesë përtej asaj që IKS mund të ofrojë, duke pasur parasysh burimet dhe kapacitetet në dispozicion.

Për të përmirësuar më tej përputhshmërinë me KoP-in, Ekipi i “Peer Review” rekomandon që:

- 13. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të forcojë marrëdhëniet me përdoruesit në bazë të grupeve punuese sipas lëndës për të kuptuar më mirë nevojat e përdoruesve dhe për të marrë reagime në lidhje me përvojat e tyre me produktet statistikore. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, treguesi 11.1.)**

3.2.4.2 ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE MË TË FORTA ME AKADEMINË DHE INSTITUCIONET KËRKIMORE

Sipas përvojës së shumë IKS-ve, zhvillimi i marrëdhënieve me universitetet dhe institucionet kërkimore mund të jetë veçanërisht i frytshëm. ASK-ja ka vendosur marrëdhënie me departamentet universitare dhe institutet kërkimore. Ndër të tjera, ASK-ja ofron qasje në disa nga mikro-të dhënat e tyre në një ambient të sigurt për kërkuesit.

ASK-ja duhet të ofrojë më shumë informacion mbi shërbimet që ofrohen tashmë për hulumtuesit dhe duhet të ndërmer veprime për të promovuar përdorimin e të dhënave të saj për qëllime kërkimore, duke tërhequr në mënyrë aktive bashkëpunimin me universitetet. Të dhënat, duke përfshirë mikro-të dhëna të anonimituara nga anketa e buxhetit të familjeve, nga EU-SILC dhe në përgjithësi nga statistikat sociale, janë shumë të përshtatshme për punën kërkimore të studentëve, siç janë tezatat për magistraturë. Bashkëpunimi me universitetet, siç janë analizat e përbashkëta, mund të ndihmojë gjithashtu për t'iu përgjigjur pyetjeve që janë përtej ekspertizës dhe kapacitetit të stafit të ASK-së. Përvoja e IKS-ve të tjera tregon se një bashkëpunim i tillë shihet si prestigjioz nga publiku. Bashkëpunimi me universitetet mund të përdoret gjithashtu për të diskutuar zhvillimet metodologjike, të TI-së dhe inovacionit. Ekipi i "Peer Review" mirëpret që ASK-ja ofron praktika për studentët, një shërbim që gjithashtu duhet të zhvillohet më tej.

Për të përmirësuar më tej përputhshmërinë me KoP-in, Ekipi i "Peer Review" rekomandon që:

- 14. Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të zhvillojë marrëdhënie më të forta me akademinë duke zgjeruar shërbimin e saj për qasje në të dhëna duke përfshirë mikro-të dhëna anonime për qëllime kërkimore, duke ofruar praktika për studentët dhe duke bashkëpunuar në kryerjen e analizave të përbashkëta. (Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Treguesit 7.7 dhe 15.4.)**

3.3 PIKËPAMJET E INSTITUTIT KOMBËTAR TË STATISTIKAVE QË DALLOJNË NGA VLERËSIMI I EKIPIT TË "PEER REVIEW"

ASK-ja mirëpret raportin e Ekipit të "Peer Review" dhe pajtohet në nivel të përgjithshëm me gjetjet dhe rekomandimet, megjithatë ASK-ja dëshiron të shpreh pikëpamje të ndryshme për dy rekomandime.

I pari ka të bëjë me rekomandimin për transferimin e pozitave nga zyrat rajonale në selinë qendrore (Rekomandimi 7). ASK-ja pajtohet se duhet të vazhdojë të monitorojë ngarkesën e punës dhe produktivitetin e zyrave të saj rajonale për të liruuar burimet potenciale të disponueshme për t'u rialokuar për aktivitetet e tjera në selinë e saj. Aktualisht nuk ka resurse për t'u zhvendosur pa u vënë në rrezik procesi i mbledhjes së të dhënave. Gjithashtu, përmes Rregullores për Riorganizimin e ASK-së (Reg.No.01/2013), në pajtim me Nenin 14 paragrafi 4, Kryeshefi Ekzekutiv ka racionalizuar disa pozita nga Departamenti i Anketave dhe Regjistrimeve (i cili përbëhet nga të gjitha zyrat rajonale) si dhe njësinë për futjen e të dhënave (stafi i futjes së të dhënave), dhe i ka rialokuar këto pozita në Njësinë e Llogarive Kombëtare dhe në njësitë e tjera të prodhimit statistikor në ASK. Përveç kësaj, ne kemi njoftuar Ekipin e "Peer Review" se brenda Marrëveshjes Kosovë-Serbi në Bruksel, të lehtësuar nga BE-ja, 10 pozita janë vendosur në ASK me vendime politike dhe ky numër ka rritur ndjeshëm numrin e stafit të Zyrës Rajonale nga 38 në 48 .

E dyta ka të bëjë me monitorimin dhe kontrollimin e punës së anketuesve (Rekomandimi 10). ASK-ja pajtohet lidhur me përmirësimin e proceseve për të monitoruar dhe kontrolluar punën e anketuesve që kryejnë mbledhjen e të dhënave. Monitorimi dhe kontrollimi duhet të përqendrohet vetëm në një pjesë specifike (gjetjet nga kontrollimi që lidhen me operimin në terren) të procesit të mbledhjes së të dhënave, ku nevojiten përmirësime, duke krijuar një qasje të përbashkët për të

gjitha departamentet e lëndëve në lidhje me monitorimin e tyre në terren. Përndryshe anketuesit janë të trajnuar mirë në lidhje me besueshmërinë, shumë vëmendje i kushtohet çështjes së sjelljeve të anketuesve, madje edhe se si të paraqitet përpara kryefamiljarit, për të shpjeguar qëllimin e vizitës së tij/saj, për të shpjeguar se të dhënat do të mbrohen me ligj, rezultatet që do të publikohen janë vetëm në nivel të agreguar (të përgjithshëm), etj.

SHTOJCA A: PROGRAMI I VIZITËS

VIZITA E EKIPIT TË “PEER REVIEW” NË KOSOVË

24–28 korrik 2017

AGJENDA

Koha	Programi
Dita 1 – E hënë 24 korrik 2017	
09.00–10.30	Diskutimet e Ekipit të “Peer Review” për të finalizuar përgatitjen e vizitës
10.30–11.00	Pushim i kafesë
11.00–12.00	Takimi përgatitor me ekipin koordinues të ASK dhe, eventualisht, pjesëmarrësit e tjerë kombëtarë në vizitë për të diskutuar aspektet praktike të vizitës
12.00–13.00	Dreka
13.00–15.00	Mirëseardhja dhe paraqitja e programit, miratimi i agjendës, çështjet organizative. Prezantimi i Sistemit Kombëtar të Statistikave (Sesioni i informimit të përgjithshëm me përshkrimin se si është organizuar SKS).
15.00–15.15	Pushim i kafesë
15.15–16.15	Roli koordinues i IKS
16.15–17.00	Takimi i Ekipit të “Peer Review”
Dita 2 – E martë 25 korrik 2017	
09.00–10.30	Ligji i statistikave dhe legjislacioni përkatës (Parimet e KoP 1, 2, 5 dhe 6)
10.30–10.45	Pushim i kafesë
10.45–12.45	Programimi, planifikimi dhe burimet, duke përfshirë trajnimin (Parimet e KoP 3, 9 dhe 10)
12.45–13.30	Dreka
13.30–15.45	Cilësia (struktura organizative, mjetet, monitorimi ...) (Parimet e KoP 4 dhe 11 deri në 15)
15.45–16.00	Pushim i kafesë
16.00–17.30	Shpërndarja, duke përfshirë konfidencialitetin dhe konsultimin e përdoruesve (Parimet e KoP 5, 6, 11 dhe 15)
Dita 3 – E mërkure 26 korrik 2017	
09.00–10.30	Metodologjia, grumbullimi i të dhënave, përpunimi i të dhënave dhe të dhënat administrative (Parimet e KoP 2, 7 dhe 8)
10.30–10.45	Pushim i kafesë
10.45–12.00	Metodologjia, grumbullimi i të dhënave, përpunimi i të dhënave dhe të dhënat administrative (Parimet e KoP 2, 7 dhe 8).
12.00–13.00	Dreka
13.00–14.15	Takim me stafin e ri
14.15–15.30	Takimi me Autoritetet e tjera Kombëtare (AtK): Banka Qendrore e Kosovës
15.30–15.45	Pushim i kafesë
15.45–17.00	Takimi me Autoritetet e tjera Kombëtare (AtK): Ministria e Financave
Dita 4 – E enjte 27 korrik 2017	

Koha	Programi
09.00–10.30	Takimi me përdoruesit kryesorë - ministritë dhe institucionet e tjera publike / private (përfshirë Bankën Qendrore si përdorues).
10.30–10.45	Pushim i kafesë
10.45–12.45	Takimi me ofruesit / respondentët kryesorë të të dhënave
12.45–14.00	Dreka
14.00–15.00	Takimi me përdoruesit kryesorë - mediat
15.00–15.15	Pushim i kafesë
15.15–16.15	Takimi me përdoruesit kryesorë - komuniteti shkencor
16.15–17.15	Takim me organizatat ndërkombëtare
Dita 5 – E premte 28 korrik 2017	
08.00–09.00	Diskutim i Ekipit të “Peer Review”
09.00–12.00	Takimi me menaxhmentin e lartë: përfundimet dhe rekomandimet
12.00–13.00	Dreka
13.00–15.00	Përgatitja e raportit: ndarja e detyrave

SHTOJCA B: LISTA E PJESËMARRËSVE

	Ekipi i “Peer Review”
1	Z. Jean-Michel Durr (kryesues), ekspert kryesor
2	Z. Peter Hackl, ekspert
3	Z. Marius Andersen, Eurostat
	Vëzhgues i Eurostat
4	Zj. Veneta Boneva, Vëzhguese (Eurostat)
5	Z. Maldi Dema, Vëzhgues (INSTAT)
	Menaxhmenti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës
6	Z. Isa Krasniqi, Kryeshef Ekzekutiv
7	Z. Ibrahim Rrustemi, Drejtor i Departamentit për Politikë, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim
8	Z. Ilir T.Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare
9	Z. Ramiz Ulaj, Drejtor i TI dhe Metodologjisë
10	Z. Bajrush Qevani, Drejtor i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
11	Z. Avni Kastrati, Drejtor i Statistikave Sociale
12	Znj. Melihate Tahiri, Drejtore e Administratës
	Ekipi koordinues i Ekipit të “Peer Review” në Agjencinë e Statistikave të Kosovës
13	Z. Ibrahim Rrustemi, Drejtor i Departamentit për Politikë, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim
14	Znj. Teuta Zyberi, Marrëdhëniet Ndërkombëtare
15	Znj. Arta Salihi-Morina, Koordinatore e Brendshme
16	Zj. Hazbije Qeriqi, Komunikimi me Media
	Pjesëmarrës të tjerë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës
17	Zj. Shqipe Makolli, Menaxhere e Burimeve Njerëzore
18	Z. Burim Limolli, Udhëheqës i Divizionit të TI dhe Metodologjia
19	Zj. Drita Sylejmani, Zyrtare e Lartë për Diseminim
20	Z. Bekim Canolli, Shef i Metodologjisë dhe Diseminimit
21	Zj. Servete Muriqi, Shefe e Metodologjisë
22	Zj. Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare
23	Zj. Violeta Arifi-Gashi, Shefe e Departamentit të Bujqësisë
24	Zj. Emina Deliu, Udhëheqëse e Sektorit e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare
25	Zj. Besa Haqifi, Zyrtare e Lartë për Standardet e Jetesës
26	Zj. Arijeta Sojeva, Statistikat Vitale
	Stafi i ri nga Agjencia e Statistikave të Kosovës
27	Zj. Teuta Zyberi, Marrëdhëniet ndërkombëtare
28	Zj. Hazbije Qeriqi, Komunikimi me media

29	Z. Burim Limolli, Udhëheqës i Divizionit IT dhe Metodologjia
30	Z. Arbert Avdyli, Përkthyes
31	Z. Idriz Hoxha, Administrator i TI
32	Z. Bekim Bojku, Statistikat e Energjisë
33	Zj. Kaltrina Veselaj, Llogaritë Kombëtare
34	Zj. Ardita Hajredini, GIS
35	Z. Arlinda Berisha-Emini, Statistikat e Bujqësisë
36	Z. Nysret Sylejmani, Llogaritë Kombëtare
	Përfaqësues të Ministrive dhe institucioneve të tjera publike / private
37	Zj. Xhevahire Izmaku, Deputete në Kuvendin e Kosovës
38	Z. Vedat Sagonjeva, Zyra e Kryeministrit / Zyra e Planifikimit Strategjik
39	Zj. Blerta Kika, Analiste e Lartë për Makroekonominë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave
40	Zj. Ganimete Xhaka, Analiste e Lartë për Makroekonominë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave
41	Zj. Delvina Hana, Analiste për Analiza Ekonomike, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
42	Z. Shpetim Kalludra, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
43	Z. Jeton Karaqica, Ministria e Integritimit Evropian
44	Z. Valon Avdiu, Ministria e Integritimit Evropian
45	Z. Edi Gusia, Zyra e Barazisë Gjinore
46	Zj. Blerinda Idrizi, DADA6 Niras (Çështjet Gjinore)
	Përfaqësuesit e përdoruesve kryesorë, ofruesve të të dhënave / të anketuarve
47	Z. Sakip Imeri, Drejtor i Autoritetit Tatimor të Kosovës
48	Z. Enver Makolli, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
49	Z. Besnik Ramosaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës
50	Z. Naser Hasani, Këshilli Gjyqësor i Kosovës
51	Z. Vedat Maqastena, Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë
	Përfaqësuesit e komunitetit shkencor
52	Z. Dukagjin Zeka, Universiteti Publik "Hasan Prishtina" - Fakulteti i Bujqësisë
53	Z. Bedri Dragusha, Universiteti Publik "Hasan Prishtina" - Fakulteti i Bujqësisë
54	Z. Sylë Sylanaj, Universiteti Publik "Hasan Prishtina" - Fakulteti i Bujqësisë
55	Z. Berat Thaçi, Instituti Kërkimor - Instituti GAP - Politika ekonomike
	Përfaqësuesit e medias
56	Zj. Albulena Avdiu, Ekonomia online
57	Zj. Albulena Mavraj, Epoka e Re
	Pjesëmarrës nga AtK
58	Z. Bedri Zymeri, Drejtor i Departamentit të Statistikave, Banka Qendrore e Kosovës

59	Zj. Shqipe Haredini, Zyrtare e Statistikave, Banka Qendrore e Kosovës
60	Z. Shkelzen Ademi, Zyrtar i Statistikave, Banka Qendrore e Kosovës
61	Zj. Blerta Kika, Analiste e Lartë për Makroekonominë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave
62	Zj. Ganimete Xhaka, Analiste e Lartë për Makroekonominë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave
63	Z. Arif Hoti, Këshilltar i Ministrit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave
	Takim me organizatat ndërkombëtare
64	Z. Brandao Co, UNICEF
65	Zj. Arijeta Gjokolli, UNICEF
66	Zj. Valbona Ismaili, SIDA / SCB